



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202200897/8

Tiranë ___/___/2022

Lënda : *Rekomandim për dërgimin e menjëhershëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier të dokumentit të aplikimit nr. 8403, datë 04.06.2018 bërë nga shtetasi M.B., për shërbimin e regjistrimit të Kontratës së shkëmbimit nr. 956 Rep. dhe nr. 613/1 Kol., datë 15.05.2018, lidhur ndërmjet investitorit "---" Sh.a. dhe pronarëve të truallit M.B dhe Z.B., si dhe të kopjes së kësaj kontrate.*

AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS
Vlorë

Me shkresën nr. K2/N6-4 prot., datë 20.07.2022 ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetësja N.B., me banim në qytetin e Vlorës. Ankuesja shkruan se është një nga bashkëpronarët e një trualli me sip. 673 m², i cili ndodhet në Zonën Kadastrale Nr. 8601, me Nr. Pasurie 17/76, e regjistruar në ZVRPP Vlorë, në Volumin 16, Faqe 52, në lagjen "Hajro Çakërr", Vlorë. Në vitin 2018 bashkëpronarët e këtij trualli kanë lidhur një kontratë sipërmarrje dhe më vonë shkëmbimi me Shoqërinë "--" sh.a., e cila do të ndërtonte me financimet e veta një godinë banimi dhe shërbime 2-9 kate, plus një kat parkim nëntokë. Objekti i kontratës së shkëmbimit ishte shkëmbimi ligjor i pasurisë (truallit me sip. 673 m²) me pasuri të llojit "apartament", "njësi" dhe "garazh" që do të ndërtoheshin nga shoqëria.

Në zbatim të kësaj kontrate bashkëpronarët e truallit morën pjesën e apartamenteve, njësisve dhe garazheve duke i regjistruar ato në emrin e tyre në ZVRPP Vlorë. Pas kësaj procedure ata janë vënë në dijeni nga përfaqësuesi i Shoqërisë "--" sh.a. se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka vendosur sekuestro të pasurive të kësaj

shoqërie, ndër të cilat edhe disa apartamente, njësi dhe garazhe të ankueses N.B. dhe të kunatës së saj, shtetases Z.B..

Sipas ankueses, pasuritë takuese të tyre janë sekuestruar nga organi i prokurorisë për shkak të gabimeve të ZVRPP Vlorë (aktualisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës), sepse nuk ka kryer veprimet përkatëse për kalimin e këtyre pasurive nga shoqëria ndërtuese sipërmarrëse, tek pronarët e truallit mbi të cilin u bë ndërtimi në fjalë. Për shkak të mosveprimit të kësaj zyre në zbatim të kontratës së shkëmbimit, pasuritë e sekuestruara figuronin në pronësi dhe në emër të shoqërisë ndërtuese. Si pasojë e mosveprimit të kësaj agjencie, është bërë padrejhtësisht sekuestrimi i pjesës së tyre takuese nga kontrata e sipërmarrjes dhe e shkëmbimit, duke iu cenuar e drejta kushtetuese e ligjore e pronësisë së tyre.

Gjithashtu ankuesja shkruan se ndonëse pronarët e këtij trualli nuk kanë kryer ndonjë shkelje ligjore që do të sillte si pasojë sekuestrimin e pasurive të tyre, por në fakt po mbushen rreth 4 vjet nga vendosja e sekuestrimit dhe aktualisht pronat e tyre vijojnë ende të jenë të sekuestruara.

Përveç sa më sipër, ankuesja shkruan se nuk e di se çfarë problemesh penale ka Shoqëria “--” Sh.a., por ajo dhe kunata e saj, shtetësja Z.B., janë pronare të ligjshme të këtyre pronave të cilat janë përfituar nëpërmjet kontratave të ligjshme të cituara më sipër. Për këtë arsye, sipas saj, nuk ka asnjë shkak ligjor për sekuestrimin e pronave të tyre, sikurse është vepruar nga organi i prokurorisë.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj ankese ju kërkua që të na dërgonit një informacion lidhur me:

1. Cili është qëndrimi juaj lidhur me pretendimet e ankueses se nga ZVRPP (Agjencia Shtetërore e Kadastrës) Vlorë nuk është vepruar në kohë lidhur me kalimin e pronësisë (pasurisë takuese) të tyre që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes dhe ajo e shkëmbimit me Shoqërinë “ --” sh.a., e cila ka ndërtuar me financimet e veta një godinë banimi dhe shërbime 2-9 kate, plus një kat parkimi në nëntokë?
2. Mbi bazën e cilit dokument është bërë sekuestrimi i pronave të ankueses N.B. dhe kunatës së saj, shtetases Z.B.?
3. Cila është procedura e ndjekur nga ZVRPP Vlorë lidhur me sekuestrimin e pasurive shtetaseve N.B. dhe Z.B.?
4. Së bashku me informacionin ju kërkua që të na dërgonit edhe fotokopjen e korrespondencës që ka pasur ZVRPP Vlorë me ankuesen dhe organet ligjzbatuese lidhur me sekuestrimin e pasurive në fjalë.

Në vijim të kërkesës tonë, ju me shkresën nr. 8089/1 prot., datë 08.08.2022 ndërmjet të tjerave na informuat se, nga verifikimi në sistemin elektronik multifunksional, si dhe në arkivin e ASHK Vlorë rezulton se shtetasi M.B., me cilësinë e pronarit të truallit ka bërë aplikimin nr. 8403, datë 04.06.2018 për shërbimin e regjistrimit të Kontratës së shkëmbimit nr. 956 Rep. dhe nr. 613/1 Kol., datë 15.05.2018, lidhur ndërmjet investitorit “--” Sh.a. dhe pronarëve të truallit M.B. dhe Z.B..

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me shkresën nr. 6218/14 prot., datë 01.06.2018, protokolluar me tuajën me nr. 256 prot., datë 06.06.2018 (shkresa hyrëse) ka dërguar për ekzekutim urdhrin penal të sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të investitorit “--” Sh.a.”, bazuar në vendimin nr. 2885, datë 31.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier “Për vendosjen e sekuestros preventive”.

Ndërsa me shkresën nr. 2810 prot., datë 19.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, protokolluar me tuajën me nr. 486 prot., datë 20.07.2018, është dërguar urdhri i ekzekutimit të vendimit penal nr. 14, datë 17.07.2018.

Gjithashtu në këtë shkresë na informuat se, Kontrata e shkëmbimit nr. 956 Rep. dhe nr. 613/1 Kol., datë 15.05.2018 (lidhur ndërmjet investitorit “--” Sh.a. dhe pronarëve të truallit M.B. dhe Z.B.), është aplikuar për regjistrim më parë, konkretisht në datën 04.06.2018, ndërsa certifikatat e pronësisë kanë dalë përkatësisht në datën 20.06.2018) për bashkëpronarët E.B. dhe N.B.), ndërsa për shtetasit M.B. dhe Z.B. në datën 06.06.2018 (referuar shënimeve në kartelën fizike të pasurisë së paluajtshme).

Bashkë me informacionin e cituar më sipër, ju na dërguat edhe fotokopje të shkresës “Kthim përgjigje” të ZVRPP Vlorë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier.

Ndërkohë lidhur me këtë ankesë ne i kërkuam informacion edhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier. Ky organ me shkresën nr. 5816/1 prot., datë 25.07.2022, ndërmjet të tjerave na informoi se, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier ka regjistruar procedimin penal nr. 258, i vitit 2010 në ngarkim të shtetasve A., V., M., Sh. e J.Ç. si dhe Xh.T. për veprat penale “Mospagimi i tatim-taksave”, “Fshehja e të ardhurave”, “Mashtrimi” dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga nenet 180/3-25, 181-25, 143/3 dhe 287/2 të Kodit Penal.

Po kështu u informuam se kjo prokurori ka regjistruar procedim penal edhe ndaj personit juridik, shoqërisë “--”, Sh.a. me nr. nipti K82821402H, datë themelimi 14.04.2008, me seli qendrore në Fier Qendër, Fier, Shqipëri; si dhe ndaj personit juridik “—” Shpk, data e themelimit 25.03.2002, me seli qendrore në Fier, Shqipëri.

Gjatë hetimeve paraprahe, Gjykata e Shkallës së Parë Fier me vendimin nr. 62-2018-2885, datë 31.05.2018 ka vendosur sekuestro preventive në të gjithë pasuritë e krijuara nga

veprimtaria kriminale e të pandehurve. Ky vendim është vënë në zbatim nga organi i prokurorisë me urdhrin e datës 31.05.2018 dhe se me këtë urdhër janë njohur të gjitha institucionet, përfshi edhe Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Vlorë ose ish ZVRPP Vlorë.

Duke iu referuar përgjigjes tuaj konstatojmë se, nuk na keni dërguar informacion të plotë lidhur me pretendimet e ankueses dhe konkretisht, nëse nga zyra juaj janë regjistruar të gjitha pronat e pronarëve të truallit (respektivisht pasuritë me nr. 17/75/ND-N2, Vol. 35, fq. 124, sip. 117 m², sip. Pb. 10m², Lloji Njësi; nr. 17/75/ND-N20, Vol. 35, fq. 143, sip. 13.4m², sip. Pb. 3.5m², Lloji Njësi; nr. 17/75/ND+1-36, Vol. 35, fq. 186, sip. 82.2m², sip. Pb. 7.6m², Lloji Ap; nr. 17/75/ND+2-38, Vol. 35, fq. 232, sip. 46.7m², sip. Pb. 5.1m², Lloji Ap), mbi të cilin është ndërtuar një godinë banimi dhe shërbime 2-9 kate, plus një kat parkim në nëntokë nga investitori “ --” Sh.a., siç përcaktohet në Kontratën e shkëmbimit nr. 956 Rep. dhe nr. 613/1 Kol., datë 15.05.2018, lidhur ndërmjet investitorit “ --” Sh.a. dhe pronarëve të truallit M.B. (Bani) dhe Z.B. si dhe nëse janë lëshuar certifikatat e pronësisë, kartelat dhe hartat përkatëse të gjithë këtyre pronave.

Ndërkohë nuk na keni dërguar asnjë lloj informacioni apo korrespondence që ZVRPP Vlorë të ketë bërë me dije pronarët e truallit në fjalë lidhur me dokumentacionin e dërguar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me shkresën nr. 6218/14 prot., datë 01.06.2018, për ekzekutimin e urdhrin penal të sekuestros preventive mbi pasuritë e paluajtshme të regjistruara në emër të investitorit “ --” Sh.a.”, bazuar në vendimin nr. 2885, datë 31.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier “Për vendosjen e sekuestros preventive”. Po ashtu nuk na keni informuar nëse ankuesit janë bërë me dije mbi shkresën nr. 2810 prot., datë 19.07.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, protokolluar me tuajën me nr. 486 prot., datë 20.07.2018, me të cilën është dërguar urdhri i ekzekutimit të vendimit penal nr. 14, datë 17.07.2018.

Gjithashtu konstatojmë se, në shkresën e ZVRPP Vlorë dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier nuk është bërë me dije organi i prokurorisë lidhur me aplikimin në ZVRPP Vlorë për depozitimin të Kontratës së shkëmbimit nr. 956 Rep. dhe nr. 613/1 Kol., datë 15.05.2018, të lidhur ndërmjet investitorit “ --” Sh.a. dhe pronarëve të truallit M.B. dhe Z.B.. Ndërkohë që në këtë shkresë i kërkohet përgjigje organit të prokurorisë se si duhet të veprojnë kjo zyrë me 6 prona pjesë e listës së pronave të sekuestruara në bazë të vendimit gjyqësor të cituar më lart, të cilat ishin regjistruar dhe lëshuar certifikatat e pronësisë. Sqarojmë se të gjitha këto prona u përkasin shtetasve të tjerë, të ndryshëm nga ankuesit. Mosdijenja e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në lidhje me kontratën e shkëmbimit të cituar më sipër provohet edhe nga përgjigjja e dërguar institucionit tonë nga ky organ, të cilën e përshkruam më lart.

Ndërkohë konstatojmë se në këtë shkresë të ZVRPP me lëndë “Kthim përgjigje” dërguar organit të prokurorisë mungojnë disa elemente të domosdoshëm të anës formale dhe vlefshmërisë së një dokumenti zyrtar, si numri i protokollit dhe data e saj.

Në vlerësim të informacionit të dërguar dhe dokumentacionit shoqërues, ne kemi bindjen se, nëse nga ZVRPP Vlorë do të ishte informuar organi i prokurorisë lidhur me aplikimin e bërë nga njëri prej pronarëve të truallit për regjistrimin e Kontratës së shkëmbimit të cituar më sipër, atëhere për shkak të këtij fakti juridik organi i prokurorisë do t'i drejtohej me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për të bërë korigjimin e vendimit të sekuestrimit dhe heqjen e sekuestros mbi pronat e pronarëve të truallit. Sqarojmë se, referuar informacionit të dërguar nga organi i prokurorisë, rezulton në mënyrë të qartë se procedimi penal nr. 258, i vitit 2010, për të cilën është vendosur sekuestro preventive të gjitha pasurive të krijuara nga veprimtaria kriminale e të pandehurve, është regjistruar në ngarkim të shtetasve A., V., M., Sh. e J.Ç., Xh.T., si dhe ndaj personave juridikë "--" Shpk dhe "--" Sh.a., e cila është investitore e godinës së ndërtuar në truallin e pronarëve M.B., etj., dhe jo ndaj këtyre të fundit.

Përveç sa më sipër, konstatojmë se nga ZVRPP Vlorë nuk janë njoftuar as aplikuesi M.B. dhe pronarët e truallit ndër të cilët janë edhe ankuesja dhe kunata e saj, për aktet (vendimet gjyqësore dhe urdhrat e ekzekutimit të tyre) në bazë të të cilave është bërë sekuestrimi i pronave të "--" Sh.a. dhe të pronarëve të truallit. Ne vlerësojmë se ZVRPP Vlorë ka patur detyrimin ligjor për të vënë në dijeni menjëherë si aplikuesin ashtu edhe pronarët e tjerë të truallit për vendosjen e sekuestros preventive ndaj pronave të tyre, si dhe fotokopje të këtij dokumentacioni. Nga mosdhënia e informacionit dhe dokumentacionit lidhur me situatën juridike të krijuar pas dërgimit nga organi i prokurorisë të akteve të cituara më lart, atyre iu është cenuar e drejta për të ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe kryer veprimet ligjore për të mbrojtur të drejtën e pronësisë në rrugë gjyqësore.

Qëndrimi i mbajtur në këtë rast nga ZVRPP Vlorë, është në kundërshtim të plotë dhe të hapur me parimin e ligjshmërisë, transparencës, informimit, dhënies së ndihmës aktive, drejtësisë dhe paanësisë, përgjegjësisë, deburokratizimit dhe efijencës, sikurse parashikohet në nenet 1, 4, 5, 6, 10, 13, 14, 15, dhe 18, të Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë¹, të cilat janë të detyrueshme për zbatim nga punonjësit e administratës publike.

¹ Neni 1 "Qëllimi i ligjit" parashikon se:

Ky Kod ka për qëllim të sigurojë realizimin efektiv të funksioneve publike administrative në shërbim të personave, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të interesave të ligjshëm të tyre, në realizimin e këtyre funksioneve, duke zbatuar parimin e procesit të rregullt ligjor.

Neni 4 "Parimi i ligjshmërisë" parashikon se:

1. Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislationin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.
2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor.

Neni 5 "Parimi i transparencës" parashikon se:

Organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të.

Neni 6 "Parimi i informimit" parashikon se:

Ky qëndrim i mbajtur gjatë procesit të trajtimit të aplikimit të shtetasit M.B. për pasuritë me nr. 17/75/ND-N2, Vol. 35, fq. 124, sip. 117 m², sip. Pb. 10m², Lloji Njësi; nr. 17/75/ND-N20, Vol. 35, fq. 143, sip. 13.4m², sip. Pb. 3.5m², Lloji Njësi; nr. 17/75/ND+1-36, Vol. 35, fq. 186, sip. 82.2m², sip. Pb. 7.6m², Lloji Ap; dhe nr. 17/75/ND+2-38, Vol. 35, fq. 232, sip. 46.7m², sip. Pb. 5.1m², Lloji Ap, ka cenuar dhe vazhdon të cenojë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për lëshimin e dokumenteve të pronësisë, të cilat sigurojnë jo vetëm veprimtarinë e rregullt të organit tuaj, por edhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të shtetasve apo të shtetit, të mbrojtura posaçërisht nga aktet normative në fuqi.

Gjithashtu ne vlerësojmë se ky qëndrim i mbajtur ndaj pronarëve të truallit në fjalë, nëpërmjet mosveprimit të punonjësve të ZVRPP Vlorë, ka sjellë si pasojë cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, sikurse parashikohet në nenin 41/1/2²

1. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit.

2. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe i njoftohet menjëherë palëve në proces.

Neni 10 “Parimi i dhënies së ndihmës aktive” parashikon se:

1. Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.

2. Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik.

3. Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padija e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.

Neni 13 “Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë” parashikon se:

Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Neni 14 “Parimi i objektivitetit” parashikon se:

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative.

Neni 15 “Parimi i përgjegjësisë” parashikon se:

Organet publike dhe nëpunësit e tyre, kur kryejnë një procedurë administrative, mbajnë përgjegjësi për dëmet që u shkaktojnë palëve, në përputhje me legjislacionin përkatës.

Neni 18 “Parimi i deburokratizimit dhe i efikasitetit” parashikon se:

1. Procedura administrative nuk i nënshtrohet ndonjë forme të caktuar, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji.

2. Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.

² Neni 41 parashikon:

“1. E drejta e pronës private është e garantuar.

2. Prona fitohet me dhurim, me trashëgimi, me blerje dhe me çdo mënyrë tjetër klasike të parashikuar në Kodin Civil....”

dhe 42³ të Kushtetutës, nenin 6/1 të Konvetës Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe nenin 1 të Protokollit nr.1 të kësaj Konvente.

Për shkak të kësaj mase penale, vendosjes së sekuestros preventive, ankueses dhe bashkëpronarëve të truallit mbi të cilin është ndërtuar një godinë banimi dhe shërbime 2-9 kate, plus një kat parkim në nëntokë nga investitori “ --” Sh.a., u është privuar e drejta ligjore për të kryer transaksione ligjore lidhur me disponimin e pronave të tyre. Gjithashtu, si rrjedhojë e mosveprimeve të paligjshme të ZVRPP Vlorë, ankueseve dhe pronarëve të tjerë të këtyre pronave të sekuestruara u është shkaktuar një dëm i konsiderueshëm pasuror dhe moral njëkohësisht.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3 të nenit 63 të Kushtetutës ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*” dhe në gërmën “b” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*”,

REKOMANDOJMË :

Marrjen e menjëhershme të masave të nevojshme për dërgimin në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier të dokumentit të aplikimit nr. 8403, datë 04.06.2018, bërë nga shtetasi M.B., për shërbimin e regjistrimit të Kontratës së shkëmbimit nr. 956 Rep. dhe nr. 613/1 Kol., datë 15.05.2018, lidhur ndërmjet investitorit “ --” Sh.a. dhe pronarëve të truallit M.B. dhe Z.B., si dhe të kopjes së kësaj kontrate, për t’u bërë vlerësimi përkatës nga ky organ kompetent në vijim.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

³ Neni 42 parashikon se:

“1. Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor.

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

